# DËSHMI ARKIVI

**A-457255**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Falsifikuan dokumentet për 6 prona, në pranga ish-drejtori i ASHK Fier dhe përfituesi, sekuestrohen 715 mijë euro \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/falsifikuan-dokumentet-per-6-prona-ne-pranga-ish-drejtori-i-ashk-fier-dhe-perfituesi-sekuestrohen-715-mije-euro/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 19 shtator 2026, 09:49:43 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 09:35:55 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3b52b1f48642c89be59da7834f3514f5a2f67ceb66521e4e0099406e83925e38` |
| TEKSTI | `b9cb96c22b587f2036b63e1b0ce0271825afcb1b138c8c57df29605ecbaf5a1b` |
| PAMJA | `d098a5ed2665c078db03cdbe1f8da63f9e9804a784f6de33ad4b8ce98ea3c324` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `34ad2be390409041a1b3fe5256ede8f364f63dd968aa4ab5a57842609177bccb` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `34a49f1fb4e3ec12662634f6e1a4b8d33a530968e91968fa2be08bb537c32d65` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/34ad2be390409041a1b3fe5256ede8f364f63dd968aa4ab5a57842609177bccb`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Aktualitet

# Falsifikuan dokumentet për 6 prona, në pranga ish-drejtori i ASHK Fier dhe përfituesi, sekuestrohen 715 mijë euro



*Armelda Methasani*

*19 Shtator 2026*




**Prokuroria e Fierit** ka kërkuar dhe marrë masa sigurie ndaj tre personave, të dyshuar për përfitimin dhe regjistrimin e kundërligjshëm të gjashtë pasurive të paluajtshme në zonën e Levanit dhe Dërmënasit.

Në pranga kanë përfunduar shtetasi E.S., ish-drejtor i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Fier, dhe E.H., i dyshuar si përfituesi i pronave. Ndërsa ndaj E.R., ish-hartograf pranë ASHK Fier, gjykata ka caktuar masën e sigurisë "Detyrim për t'u paraqitur".

Hetimi i Prokurorisë lidhet me procedimin penal të nisur në nëntor 2025, për veprat penale "Falsifikimi i dokumenteve", "Mashtrimi", "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" dhe "Shpërdorimi i detyrës".

Sipas hetimeve, çështja lidhet me një vendim të vitit 2008 të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, përmes të cilit ishte njohur e drejta e kompensimit për 100 hektarë tokë bujqësore në zonën e Levanit dhe Dërmënasit.

**Një prej trashëgimtarëve, E.H., k**ishte përfituar në vitin 2018 kompensim financiar prej 53.8 milionë lekësh.

Megjithatë, sipas Prokurorisë, gjatë vitit 2023 E.H. ka ndjekur procedura për regjistrimin e gjashtë pasurive në zonën kadastrale nr. 2436, me një sipërfaqe totale prej rreth 71.7 hektarësh, duke iu referuar një vendimi të vitit 2008.

Hetuesit dyshojnë se në këtë proces janë kryer veprime të kundërligjshme nga ish-drejtori i ASHK Fier, E.S., dhe ish-hartografi E.R., në lidhje me trajtimin administrativ dhe kadastral të dokumentacionit të përdorur për regjistrimin e pronave.

dokumentacionit të përdorur për regjistrimin e pronave.

Pas regjistrimit, disa prej këtyre pasurive dyshohet se janë shitur, duke gjeneruar të ardhura të konsiderueshme. Prokuroria po heton transaksionet, lëvizjen e parave dhe destinacionin e tyre.

Në kuadër të hetimit janë sekuestruar edhe 715.976 euro, të cilat ndodheshin në llogarinë bankare të E.H.

Gjithashtu, janë sekuestruar dokumente, pajisje elektronike dhe materiale të tjera që pritet t'i nënshtrohen ekspertizave dhe verifikimeve të mëtejshme.

Prokuroria e Fierit vijon hetimet për të identifikuar persona të tjerë që mund të jenë përfshirë në skemë dhe për të përcaktuar përgjegjësinë penale të secilit prej personave nën hetim.


**LAJME TË NGJASHME**



Dyshohet për falsifikim, bllokohen 3100 pajisje elektronike/ Tregtoheshin pa autorizimet përkatëse!
1 MIN




Rinovimi i dokumenteve të identifikimit në çdo zyrë IdentiTek, pa kufizim nga vendbanimi!
1.5 MIN



Lehtësitë për uljen 50% të taksës së arsimit dhe pastrimit/ Dokumentet që dorëzohen në Tiranë!
2 MIN



Ish-të përndjekurit, pesë dokumentet që nevojiten për të tërhequr paratë! Ja emrat e përfituesve...
2 MIN




Zbulohet magazina në Vorë, falsifikohej skadenca e produkteve ushqimore!
2.5 MIN

**MË TË LEXUARAT**



"Nga traumat te dashuria…"/ Algert Sala zbulon nga buron frymëzimi për këngët e tij: Kur jam i mërzitur…



U hakmor duke…/Gruaja tregon se si zbuloi mesazhet e të dashurit me një tjetër!



Futbolli në zi, ndërron jetë legjenda e Interit dhe Italisë




TRAGJIKE/Shuhet ish-lojtari i NBA-së!



Solli në jetë fëmijën e saj të parë në mënyrë të fshehtë, ja se çfarë nuk dini për "shtatzëninë" e Lady Gaga-s!











Vranësira dhe reshje të dobëta, si parashikohet moti sot në vend

Greqia forcon sigurinë në burgje, 3.7 milionë euro për skanerë dhe sisteme kundër dronëve!

Nuk të vlerësoi kur ishe aty, por do të të kërkojë kur të largohesh… Përse ndodh kjo gjë?!

Rruga Milot-Balldren/ 365 mln euro nën hijen e SPAK, në konsorciumin fitues edhe emra në hetim nga Prokuroria e Posaçme!

Gazment Bardhi: SPAK ende pa asnjë kërkesë për heqjen e imunitetit që i hap rrugë arrestimit të Ballukut!

## EDITORI SUGJERON



Nuk të vlerësoi kur ishe aty, por do të të kërkojë kur të largohesh... Përse ndodh kjo gjë?!



"Njerëzit më njohin shumë serioz, por…"/ Një tjetër emër drejt BBV6? Artisti i njohur nuk e përjashton mundësinë...



"TikTok-u ka dëmtuar artistët…"/ Algert Sala: Tregu muzikor është bërë shumë më i vështirë! Shkëlqimi momental...



"Nga traumat te dashuria…"/ Algert Sala zbulon nga buron frymëzimi për këngët e tij: Kur jam i mërzitur...



"Këngën e kisha bërë para katër vitesh…"/ Algert Sala zbulon si lindi bashkëpunimi me Inis Nezirin për këngën "E imja"!



Xhelozi, flirt dhe më shumë vëmendje! Si zbulohet një dashuri e fshehtë?



Pa prisni, Maserati në bisedime me Huawei për dy modele të reja elektrike?!



Këto janë 5 ushqime që duhet t'i shmangni kur konsumoni kafe...



Electreon synon parkingjet me sistemin e ri të karikimit wireless!



3 përfitime të mundshme të probiotikëve që shkojnë përtej tretjes...

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

**LINKS**



JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.